

## **Konsultimet lokale me përfaqësuesit e shoqatave të të burgosurve të kampeve të përqendrimit dhe familjeve të viktimave mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së**

Megjugorje, Bosnjë dhe Hercegovinë,

11. dhjetor 2010.

Konsultimet lokale me përfaqësuesit e Shoqatave të të burgosurve të kampeve të përqendrimit dhe familjeve të viktimave mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së dhe Draftin e Statutit të KOMRA-së u mbajtën në bazë të organizimit të Shoqatës të burgosurve të kampeve të përqendrimit të Luftës Nacionale dhe Shoqatës së gazetarëve të BeH, me 20 pjesëmarrës: të burgosur të kampeve të përqendrimit, aktivistë për të drejtat e njeriut, politikanë, gazetarë dhe anëtarë të organizatave joqeveritare dhe anëtarë të Koalicionit për KOMRA-në. Fjalën hyrëse e mbajtën Mirko Zelenika (kryetar i Shoqatës së të burgosurve të kampeve të përqendrimit të luftës nacionale, Ivo Jerkić (Kryetar i Komunës së Çitluk, BeH), Anđelko Kvesić (Shoqata e të burgosurve të kampeve të përqendrimit të Busovaqës, BeH) dhe Milena Savić (koordinatore e procesit konsultativ të Iniciativës së KOMRA-së në BeH).

### **Shqyrtimi i propozimeve, rekomandimet dhe opinionet e pjesëmarrësve/eve:**

**Është e pamundur të bëhet KOMRA, përderisa në qeverinë boshnjake në pozitat më të larta janë ata të cilët kanë qenë bartës të luftës, të aparatit represiv. Kjo është nënçmuese për viktimat.**

*Propozoj që kjo iniciativë, për pak, të ndalojë. Mund të punoni në përmirësimin e Statutit, etj... Kur e them këtë, posaçërisht mendoj në parlamentin e Bosnjë e Hercegovinës. Parlamenti të sjellë një rezolutë, deklaratë, mund të japë deklaratë, mendim se kanë qenë konfliktet, se kanë qenë kampe të përqendrimit, dhe ajo çka është më e rëndësishmja, të propozojë dhe të thërras njerëzit, të cilët tani janë në qeverinë ekzekutive dhe legjislativë, përderisa me arsye janë nën dyshim. (...) Pra, është e pamundur të shkohet tutje me këtë, përderisa në pozitat më të larta të autoriteteve legjislativë janë njerëzit të cilët kanë qenë bartës të atij aparati represiv. Pra, kanë krijuar kampe të përqendrimit, i kanë dërguar njerëzit në drejtime të panjohura, dhe tani ne po e krijojmë KOMRA-në, e ata akoma rrinë aty. Kjo, me të vërtetë është nënçmuese për viktimat. (...) nuk është kontestues fakti i numrit të të zhdukurve. Kontestuese dhe dyshuese është gjetja e tyre, dhe tani kryesisht deri të informatat për vend ndodhjen e tyre vihet përmes parave. Këtu, autoritete relevante shtetërore pothuajse nuk bëjnë asgjë. (...) Për të burgosurit e kampeve të përqendrimit nuk ka askund evidenca, as në nivelin lokal, as në komunë, as në qytet, as në nivelin e qarkut, as të entitetit, e as në atë shtetërorë. Dhe këtë askush nuk do të mund ta bëjë, dhe nuk mund ti lihet njëfarë KOMRA-së. Ky është rol i shtetit. Dhe këtë duhet ta bëjë shteti. Pa*

*te, kjo iniciativë është e pakuptimtë. (...) Nuk munden Boshnjakët, nuk munden Kroatët t'i vërtetojnë faktet derisa nuk flet ndonjë individ nga populli im. Ne duhet ta pranojmë faktin se do të jemi të pshtyerë. Unë këtë fakt e kam pranuar para 15 vitesh, dhe tani jam i lumtur që gjendem këtu mes jush. (Mirko Zelenika, Shoqata e të burgosurve të kampeve të përqendrimit të luftës Nacionale në BeH, Mostar, BeH, Konsultimet lokale me përfaqësuesit e shoqatave të të burgosurve të kampeve të përqendrimit dhe familjeve të viktimave, Megjugorje, BeH, 11 dhjetor 2010.)*

**Nga BeH duhet të jenë tre apo gjashtë anëtarë të Komisionit, që të mos mbivotohet askush.**

*Unë do të flas lidhur me nenin 22 të draftit të statutit. Këtu ku shkruan se nga Bosnjë e Hercegovina të zgjidhen pesë anëtarë. A do të jetë kjo sërish dy Boshnjakë, dy Serbë dhe një Kroat. Kur e shoh këtu Kroacinë, mendoj se një do të jetë mjaftueshëm, e jo tre, apo Serbinë, por mendoj se nuk mjaftojnë për Bosnjë e Hercegovinën. Do të dëshiroja të kem një përgjigje në këtë çështje (...) propozoj të jenë ose tre ose gjashtë. Apo që të mos mund dikush dikë ta mbivotojë. (Josip Drežnjak, Shoqata e familjeve të të zhdukurve nga Grabovica, BeH, Konsultimet lokale me përfaqësuesit e shoqatave të të burgosurve të kampeve të përqendrimit dhe familjeve të viktimave, Megjugorje, BeH, 11 dhjetor 2010.)*

**Vetëm faktet e argumentuara mund të na shpijnë deri të një jetë kualitative.**

*Në procesverbalin e këtyre konsultimeve, të jetë propozimi që ketë paritet (barazi) në zgjedhjen e anëtarësimit, pasi që KOMRA nuk i zgjedhë anëtarët por ata i zgjedhë pushteti legjislativ apo ekzekutiv, që do të thotë se me veprim të këtillë është e sigurt se do të vijmë deri te e vërteta. A do të jetë ajo organizata A apo organizata B, kjo varet se si do të merren vesh njerëzit. Por është faktike se pa të vërtetën, pa diskutime të argumentuara nuk ka asgjë... Pra, të gjitha ato që do të kontribuojnë në atë që të evidentohet se çka ka ndodhë, por të vërtetohet me fakte, vetëm kjo do të mund të na shpijë deri të një jetë kualitative në këto hapësira. (Anđelko Kvesić, Shoqata e të burgosurve të kampeve të përqendrimit të Busovaqës, BeH, Konsultimet lokale me përfaqësuesit e shoqatave të të burgosurve të kampeve të përqendrimit dhe familjeve të viktimave, Megjugorje, BeH, 11 dhjetor 2010.)*

**Duhet të sillen një ligj i cili ndalon mohimin e krimit, ekzistimin e kampeve të përqendrimit. Dëshmitarët duhet të përgatiten mirë për dëshmi.**

*Nuk mund të thuhet se nuk ka pasur këtu kamp të përqendrimit, nuk ka pasur as aty. Kur sillen ligjet, propozimet, duhet të thuhet se ndalohet mohimi i krimit në paraqitjet publike, (...) edhe pse e ka regjistruar Kryqi i Kuq, nëse dikush është gjykuar për këto. Ka gjykime të komandantëve, ndërsa ai në nivel shteti thotë publikisht, se kampe të përqendrimit nuk ka pasë. Në koordinimin lidhur me këtë duhet qartë ta definojmë propozimin për parlamentin e Bosnjë e Hercegovinës, që të definohet shumë qartë ky ligj, se nuk mund të mohohet asnjëri kamp i përqendrimit.*

(...) Unë kam qenë dëshmitarë për të zhdukurit në Bugojanë, dëshmitarë për 21 persona. Kur ti bien para prokurorit pas 17 vitesh, bllokohesh për atë së çka ka ndodhë para tre muajsh, e lëre më para 17 vitesh. Menjëherë do ta kesh pamjen e asaj se çka ka ndodhë atë ditë. Askush nuk do të mundet. Prandaj, për mua ai gjyq është një lloj cirkusi. Ti rri i ulur aty, të incizojnë, të pyesin prej nga je, ti hutohesh dhe humbësh (...)përgatitja e dëshmitarit duhet të bëhet, gjithsesi.

... Në të gjitha rregulloret për mbrojtje ekzistojnë përshkrimet e lëndimeve (vuajtjeve) nga të cilat njerëzit kanë mbetur invalidë. Ato lista ekzistojnë për ushtarët dhe për viktimat civile të luftës. (Željko Vladić, Shoqata e të burgosurve të kampeve të përqendrimit, Mostar, BeH, Konsultimet lokale me përfaqësuesit e shoqatave të të burgosurve të kampeve të përqendrimit dhe familjeve të viktimave, Megjugorje, BeH, 11 dhjetor 2010.)

**Duhet të organizojmë një takim të përbashkët me të burgosurit e kampeve të përqendrimit dhe Koalicionin për KOMRA-në, në mënyrë që të regjistrohen të gjithë ata që kanë qenë në kampe të përqendrimit.**

Mendoj se pala boshnjake veçse e ka listën e të burgosurve të kampeve të përqendrimit (...) Le ta organizojmë një takim të përbashkët me Iniciativën për KOMRA-në dhe me ata që kanë qenë në kampet e përqendrimit të Armatës së BeH, të cilët kanë qenë në kampet e përqendrimit të Kroacisë, të cilët kanë qenë në kampet serbe të përqendrimit, të mblidhemi të gjithë. Nuk do të na përgjigjen të gjithë 100%, por gjithsesi do të kemi një numër të njerëzve që do të na përgjigjen me të cilët do të mund të fillojmë. (Zlatko Prkić, Shoqata e të burgosurve të kampeve të përqendrimit, Varesh, BeH, Konsultimet lokale me përfaqësuesit e shoqatave të të burgosurve të kampeve të përqendrimit dhe familjeve të viktimave, Megjugorje, BeH, 11 dhjetor 2010.)

**KOMRA duhet të jetë e fortë, ta zgjerojë veprimtarinë në dhënjen e opinionit për personat të cilët kanë qenë përgjegjës të krimeve, ndërsa tani janë në jetën publike.**

KOMRA duhet të jetë e fortë brenda saj, sepse aty do të jenë tre popuj, përfaqësuesit e të cilëve gjenden në Kryesi dhe pyeten, të japin mendim negativ për ata politikanë. Duhet reaguuar me mjete të lejuara sipas ligjit, me njoftim përmes mediave, me presion në palët që të mos i vënë më në lista njerëzit e tillë, gjithashtu edhe në personat të cilët i mohojnë format e ndryshme të viktimave, siç është mohimi i kampeve të përqendrimit. (...) KOMRA duhet ta zgjerojë veprimtarinë e saj, të japë mendimin e saj për personat të cilët kanë bërë vepra të këqija në luftën e kaluar. Nëse mund ta bëjë këtë, pra nëse pranojnë që këta njerëz ti tregojnë, atëherë aq janë gjasat që ajo të mbijetojë.

(Gordan Zeljko, Bordi i Qarkut të HDZ, Mostar, BeH, Konsultimet lokale me përfaqësuesit e shoqatave të të burgosurve të kampeve të përqendrimit dhe familjeve të viktimave, Megjugorje, BeH, 11 dhjetor 2010.)

**Të burgosurit e kampeve të përqendrimit nga të gjitha anët, duhet të mblidhen dhe të flasin për nevojat e tyre.**

*E mbështes iniciativën që të mblidhen të burgosurit e kampeve të përqendrimeve sipas komunave. Për shembull të Mostarit me të Mostarit. Unë do të flas dhe do ta dëgjoj Vareshin, por unë nuk e di çfarë ka ndodhë në Varesh apo në Zenicë. Le të mblidhen të burgosurit e kampeve të përqendrimit të Mostarit si nga njëra palë, ashtu edhe nga e dyta dhe e treta. (Željko Zovko, Shoqata e të burgosurve të kampeve të përqendrimit, Mostar, BeH, Konsultimet lokale me përfaqësuesit e shoqatave të të burgosurve të kampeve të përqendrimit dhe familjeve të viktimave, Megjugorje, BeH, 11 dhjetor 2010.)*

### **Secili anëtarë i KOMRA-së duhet ta ketë pëlqimin e shoqatës së viktimave.**

*... në Statut të përfshihet mënyra se si do të zgjidhen anëtarët e KOMRA-së, në mënyrë që anëtari nga Kroacia, nëse do ta marrë pëlqimin apo dritën e gjelbër nga shoqata kroate, dhe në këtë mënyrë duhet të konceptohet vendimi. Kjo do të duhej të vlejë edhe për vendet tjera... (Davor Pehar, Bordi i qytetit HDA, Mostar, BeH, Konsultimet lokale me përfaqësuesit e shoqatave të të burgosurve të kampeve të përqendrimit dhe familjeve të viktimave, Megjugorje, BeH, 11 dhjetor 2010.)*

### **Shoqatat e të burgosurve të kampeve të përqendrimit nga BeH duhet ta kenë përfaqësuesin e tyre në Këshillin Koordinues të Koalicionit për KOMRA-në.**

*Askush nuk po thotë se Koalicioni për KOMRA-në do të bëjë një mrekulli. Por, nëse në mesin e tërë asaj të keqeje dhe të krimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut, poqëse zbulojmë vetëm një pjesë të saj, një përqindje sado të vogël 10 apo 15 përqind të saj, atëherë misioni i KOMRA-së ka arritur sukses. Sukses është edhe poqëse vetëm një kryes i veprave sillet para drejtësisë. Ndërsa për mënyrën apo metodologjinë janë organizatorët, në emrin e të cilëve po flas, ata janë të gatshëm ti pranojnë propozimet e juaja. (...) mendoj se nuk do të ketë kurrfarë problemi nëse pajtohen të gjitha shoqatat që nga Bosnjë e Hercegovina, përpos Anđelko Kvesić, ta ketë edhe një anëtar tjetër të saj në Këshillin Koordinues. Këtë do të mund ta ndryshojmë qysh në takimin e parë, ky nuk do të jetë problem as për zonjën Nataša Kandić, as për Fondin për të Drejtën Humanitare, të jetë ky njeri, i cili do të na përfaqësojë. Nuk mund të lidhemi për numrin se a do të na përfaqësojnë kaq apo kaq, kryesore është që të jetë njeri kualitativ dhe me rëndësi është që të gjithë ju do të flisni për një të vërtetë. (Radmilo Golijanin, Lidhja për mbrojtjen e pronës private dhe të drejtat e njeriut. Trebinje, BeH, Konsultimet lokale me përfaqësuesit e shoqatave të të burgosurve të kampeve të përqendrimit dhe familjeve të viktimave, Megjugorje, BeH, 11 dhjetor 2010.)*